



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 348/Prot

Tiranë, më 3 / 3 /2017

Lënda: Mendim për projektin “*Transparenca e financimit të partive politike si një mekanizëm për uljen e korrupsionit në Shqipëri*”

Drejtuar: KOALICIONIT TË VËZHGUESVE VENDORË

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 1702/16F Prot., datë 16.02.2017, nëpërmjet të cilës kërkohet opinion ligjor sa i përket ngritjes së një faqe interneti e cila ka për qëllim rritjen e transparencës së financave dhe funksionimit për të gjitha partitë politike, Zyra e Komisionerit ka vlerësuar arsyetimin në vijim në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar (më tej ligji nr.9887/2008) dhe ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (më tej ligji nr.119/2014).

Ligji nr.9887/2008 kërkon që përpunimi i të dhënave të realizohet në përputhje me qëllimin e mbledhjes së tyre. Në varësi të qëllimit ju keni përcaktuar katër objektivë kryesorë për realizimin e tij.

Secili prej tyre specifikisht evidenton, transparencën e plotë të financave të partive politike dhe kandidatëve për poste publike, përpunimin e të dhënave financiare për të qenë të kuptueshme për publikun, publikimin e të dhënave mbi partitë politike në funksion të rritjes së demokracisë së brendshme dhe transparencës publike si dhe nxitjen për plotësimin e detyrave dhe vënien përpara përgjegjësisë së institucioneve përgjegjëse për rregullimin e financave të partive politike.

Në përmbushje të këtyre objektivëve, të gjithë të dhënat personale apo dokumente të cilët mbajnë të dhëna personale, të përcaktuara në pikat 1 deri në 6 dhe 8 deri 18, të përcaktuara nga ana juaj për tu bërë publike, vlerësohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe po ashtu nuk bëjnë pjesë në kufizimet e përcaktuara në nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Publikimi i të dhënave personale të individëve, renditur në kërkesën tuaj, bëhet për efekt të zhvillimit të aktivitetit të tyre në ushtrim të funksioneve në parti apo për efekt të depozitimit të kërkesës për regjistrim të partisë dhe për rrjedhojë në këtë rast përpunimi i të dhënave nuk i përket ligjit nr.9887/2008 (refererojuni nenit 4/4/b të këtij ligji).

Sa i përket publikimit të të dhënave të përcaktuara në pikën 7 “*lista e anëtarëve themelues të partisë politike*”, e cila sipas parashikimit të bërë në nenin 10 të ligjit nr.8580/2000 “Për partitë politike”, kap shifrën 3000, domosdoshmërisht kërkohet të argumentohet se bërja publike e tyre përbën interes të rëndësishëm për publikun.

“Bindja politike” bën pjesë në kategorinë e të dhënave sensitive dhe si e tillë përpunimi i saj bëhet vetëm në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 7 të ligjit nr.9887/2008, nën masa të përshtatshme mbrojtje. Rastet e këtij përpunimi ligjërohen ose me pëlqimin e subjektit të të dhënave/anëtarëve themelues, ose kur kandidohet për një post publik dhe në çdo rast tjetër me autorizim të Komisionerit nën argumentet se përbëjnë interes publik.

Rasti përjashtimor i këtij detyrimi ligjor për përpunimin e kësaj të dhëne është parashikimi i nenit 4/4/b (ligji 9887/2008), i argumentuar për kategoritë e mësipërme (pikat 1 deri në 6 dhe 8 deri 18).

Gjithashtu, në përputhje me objektivet e përcaktuar në kërkesë, në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave për të realizuar qëllimin (referojuni nenit 5/1/c të ligjit nr.9887/2008), të dhënat e përcaktuara në pikën 19 nuk gjejnë argumentim ligjor për tu bërë publike.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

